



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT DHE UJIT

V E N D I M

Nr. 22, datë 28.01.2025

PËR

MIRATIMIN E LEJES PËR NDRYSHIM PROJEKTI GJATË NDËRTIMIT PËR
OBJEKTIN: “GODINË BANIMI DHE SHËRBBIMI 2-34 KATE ME 3 KATE PARKIM
NËNTOKË”, NË “GODINË BANIMI DHE SHËRBBIME 2-34 KATE ME 4 KATE PARKIM
NËNTOKË”, ME VENDNDODHJE NË RRUGËN “DRITAN HOXHA”, BASHKIA
TIRANË

Në mbështetje të neneve 27, 28 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr.519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit” e ndryshuar, me propozim të zhvilluesit “Urbalb Construction” sh.p.k, Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit,

VENDOSI:

1. Miratimin e Lejes për ndryshim projekti gjatë ndërtimit për objektin: “Godinë banimi dhe shërbimi 2-34 kate me 3 kate parkim nëntokë”, në “Godinë banimi dhe shërbime 2-34 kate me 4 kate parkim nëntokë”, me vendndodhje në Rrugën “Dritan Hoxha”, Bashkia Tiranë, me subjekt zhvillues shoqërinë “Urbalb Construction” sh.p.k, miratuar me Vendimin Nr. 21, datë 14.12.2022 i Këshillit Kombëtar të Territorit.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave dhe Dokumenti i Rregullores së Veçantë bashkëlidhur Vendimit Nr. 21, datë 14.12.2022 i Këshillit Kombëtar të Territorit zëvendësohen me Hartën e Planvendosjes së Strukturave dhe Dokumenti i Rregullores së Veçantë që i bashkëlidhen këtij vendimi.
3. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi, pasi nënshkruhet nga kryetari, ministri i linjës dhe sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, hyjnë në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

BELINDA BALEUKU



ANËTAR / SEKRETAR I KKTU-SË

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

ADELAJDA ROKA



Nënshkruar më datë 26/06/2025